

Në bazë të nenit 95 paragrafi 3 të Kushtetutës së Malit të Zi, miratoj

## Dekret për shpalljen e ligjit për lëngjet e gazet e ndezshme

Shpall ligjin për lëngjet dhe gazet e ndezshme, të miratuar nga Kuvendi i Malit të Zi në mbledhjen e 24, në sesionin e pestë të seancës së parë të rregullt të vitit 2010, datë 22 prill 2010

Numër: 01-1438/2

Podgoricë, 29 prill 2010

Presidenti i Malit të Zi,

**Filip Vujanović, s.r.**

Në bazë të nenit 82 paragrafi 1 pika 2 dhe nenit 91 paragrafi 1 të Kushtetutës së Malit të Zi, Kuvendi i Malit të Zi, në mbledhjen e 24-t, në sesionin e pestë të seancës së parë të rregullt të vitit 2010, në datën 22 prill 2010, miratoi:

## Ligji për lëngjet dhe gazet e ndezshme

*Ligji është publikuar në “Gazetën Zyrtare të Malit të Zi”, nr. 26/2010 datë 7 maj 2010 dhe nr. 31/2010.*

### **I. DISPOZITAT BAZË**

#### **Fusha e zbatimit të ligjit**

##### **Neni 1**

Me qëllim të mbrojtjes së jetës, shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronës, gjatë ndërtimit dhe rikonstruksionit të objekteve të magazinimit, mbajtjes, tregtimit, administrimit dhe përdorimit të lëngjeve dhe gazeve të ndezshme, zbatohen masa parandaluese dhe mbrojtëse sigurie të përcaktuara në këtë ligj.

#### **Përfshirje**

##### **Neni 2**

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen për magazinimin dhe transfuzionin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme për nevojat e Ushtrisë së Malit të Zi.

#### **Përkufizime të lëngjeve dhe gazeve të ndezshme**

##### **Neni 3**

Lëngje të ndezshme janë lëngjet ose përzierje lëngjesh të cilat në temperaturën 50°C kanë presion avulli më të ulët se 300 kpa (3 bar), ndërsa pikën e ndezjes më të ulët se 100°C.

Lëngje të ndezshme me karakteristika të njohura përgjithësisht janë lëndët djegëse për mjetet motorike të cilat shiten në karburante, lëndë djegëse të lëngëta dhe lëngje të ndezshme.

Gazet e ndezshme (gazet e kompresuara, gazet e lëngëzuara dhe gazet e tretura nën presion) janë lëndë me temperaturë kritike më të ulët se 50°C ose lëndë të cilat në 50°C kanë presion avulli më të lartë se 300 kpa (3 bar).

Gazet e ndezshme me karakteristika të njohura përgjithësisht janë gazi tokësor, gazi propan-butan dhe gazi për përdorim konsumator.

#### **Transporti i lëngjeve dhe gazeve të ndezshme**

##### **Neni 4**

Transporti i lëngjeve dhe gazeve të ndezshme kryhet në bazë të rregulloreve për transportin e lëndëve të rrezikshme.

#### **Zbatimi i rregullave të procedurës së përgjithshme administrative**

##### **Neni 5**

Gjatë procedurave të parashikuara me këtë ligj zbatohen dispozitat e ligjit me të cilin është rregulluar procedura e përgjithshme administrative, në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

#### **Përkufizimi i termave**

##### **Neni 6**

Terma të veçantë të përdorur në këtë ligj kanë kuptim si vijon:

1) **tregti** është transfuzioni, ngarkimi dhe shkarkimi i lëngjeve dhe gazeve të ndezshme në mjetet e transportit ose prej tyre; administrimi gjatë dërgimit, transportimit dhe ruajtjes në depozita; dërgimi dhe transportimi me ndihmën e tubacioneve të gazit; shitja dhe përdorimi i lëngjeve dhe gazeve të ndezshme;

2) **magazinë** është objekti, pjesë e objektit ose ambient në të cilin magazinohen lëngjet dhe gazet e ndezshme;

3) **magazinim** është magazinimi i përhershëm ose i përkohshëm dhe hedhja e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme në depozita dhe kontejnerë, vëllimi i përgjithshëm i të cilëve është më i madh se 2000 litra lëngje dhe gaze të ndezshme të grupit II dhe III, ose 20 litra lëngje të ndezshme të lehtë të grupit I ose 30 kg gaze të ndezshme;

4) **depozitim** është magazinimi dhe hedhja e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme në objekte, pjesë objektesh ose jashtë tyre, në depozita, vëllimi i përgjithshëm i të cilave nuk i kalon 2000 litra lëngje dhe gaze të ndezshme të grupit II dhe III, ose 20 litra lëngje të ndezshme të lehta të grupit I apo 30 kg gaze të ndezshme ;

5) **administrim** nënkupton veprimet të cilat gjatë magazinimit, depozitimit dhe tregtimit të lëngjeve dhe gazeve të ndezshme kryhen nga persona fizikë të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj;

6) **objekti** është tërësia ndërtimore, hapësinore ose tekniko-teknologjike me instalimet, impiantet dhe pajisjet (tubacionet e naftës, tubacionet e gazit, depozitat, magazinat, impiantet etj.), ose instalimet, impiantet dhe pajisjet e ndërtuara në objekt ose të pavarura të synuara për magazinim, depozitim dhe tregtim të lëngjeve dhe gazeve të ndezshme;

7) **depozita** është një enë e mbyllur gjysmë e lëvizshme ose e lëvizshme, e cila vendoset në bazament të rregulluar posaçërisht dhe shërben për të depozituar lëngjet dhe gazet e ndezshme të vëllimeve mbi 250 litra për lëngje të ndezshme ose 50 kg për gaze të ndezshme;

8) **ena** është një enë e mbyllur e lëvizshme për depozitimin e lëngjeve ose gazeve të ndezshme me vëllim deri 250 litra për lëngun e ndezshëm ose 50 kg për gazin e ndezshëm;

9) **shishja** është enë e mbyllur me formë cilindrike për mbajtjen e lëngjeve ose gazeve të ndezshme të cilët mund të përdoren në familje, industri, laboratorë ose në raste të tjera (shishe për zhytje etj.);

10) **shishja e vogël** është enë e mbyllur për mbajtjen të lëngjesh ose gazesh të ndezshme me vëllim 0,2 litra e poshtë (Ilaqe, alkool, gaz për ndezës, spraj të mbushur me butan ose propan etj.);

11) **objekt shitjeje** është objekti i ndërtuar, pjesë e objektit të ndërtuar ose ambient i cili është i ndërtuar ose përshtatur për shitjen e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme në enë, shishe ose shishe të vogla;

12) **zona rreziku** janë zona (sipërfaqe toke, sipërfaqe ujore ose hapësirë ajrore) që përmbajnë ose mund të formojnë përzierje të ndezshme ose plasëse të avujve të lëngut të afta për djegie;

13) **distancë e sigurisë** është distancë, e cila në rast zjarri ose shpërthimi, në varësi të llojit, vëllimit dhe mënyrës së përdorimit të lëngjeve dhe gazeve të ndezshme, llojeve të objekteve dhe masave të zbatuara të sigurisë, siguron mbrojtjen e objekteve fqinje, pjesëve të objekteve dhe mjedisit;

14) **distributor** është shoqëria tregtare, person tjetër juridik ose sipërmarrës që furnizon konsumatorin me lëngje dhe gaze të ndezshme;

15) **transfuzion** është kalimi i lëngjeve dhe gazeve të ndezshme nga depozitat në depozita të transportit (autocisterna, vagona cisternë, etj.), cisterna dhe enë të mbyllura;

16) **vend transfuzioni** është vendi i caktuar posaçërisht i pajisur me pajisje të palëvizshme për rimorkimin e cisternave të transportit ose cisternave për kalimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme.

## II. MASAT E SIGURISË

### Masat e sigurisë dhe mënyra e zbatimit të tyre

#### Neni 7

Shoqëria tregtare, person tjetër juridik ose sipërmarrës, të cilët merren me magazinimin, depozitimin dhe tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme ose të cilët në kryerjen e veprimtarisë së tyre përdorin këto lëndë, janë të detyruar që të garantojnë mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, mjedisit dhe pronës dhe të zbatojnë masat parandaluese dhe mbrojtëse të përcaktuara në këtë ligj (në vijim referuar si: masat e sigurisë), rregulloret e miratuara në bazë të këtij ligji, si dhe me aktet nënligjore të miratuara me të cilat rregullohet mbrojtja dhe shpëtimi, siguria

në punë, mbrojtja e shëndetit, mbrojtja e mjedisit, rregullimi i ambientit dhe ndërtimi i objekteve.

Mënyra e zbatimit të masave të sigurisë rregullohet me aktet e përgjithshëm të shoqërisë tregtare, personit tjetër juridik ose të sipërmarrësit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

### **Detyrimet e njohjes së masave**

#### **Neni 8**

Subjektet e përmendura në nenin 7 të këtij ligji janë të detyruar që të informojnë personat të cilët administrojnë lëngjet dhe gazet e ndezshme ose që kryejnë veprime të tjera në lidhje me lëngjet dhe gazet e ndezshme, për masat e sigurisë, si dhe t'i kualifikojnë ata për veprimet në rast aksidenti tekniko-teknologjik ose aksidente të tjera, në përputhje me rregulloret për ruajtjen dhe parandalimin.

### **Magazinimi, depozitimi dhe tregtimi në përputhje me rregulloret teknike**

#### **Neni 9**

Shoqëria tregtare, personi juridik ose sipërmarrësi, janë të detyruar që magazinimin, depozitimin dhe tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme ta bëjnë në objekte të ndërtuara ose të rikonstruara, si dhe në ambiente të rregulluara për magazinimin, depozitimin dhe tregtimin e këtyre lëndëve, në përputhje me rregulloret teknike.

Lëngjet dhe gazet e ndezshme duhet të mbahen në depozita, kontejnerë, shishe ose shishe të vogla që janë në përputhje me kërkesat teknike dhe në mënyrën e përcaktuar në rregulloret teknike për llojin e caktuar të lëngut dhe gazit të ndezshëm.

Rregulloret teknike të përmendura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni miratohen nga organi i administratës shtetërore kompetent për çështjet e ruajtjes dhe shpëtimit (në vijim referuar si: ministria)

### **Depozitat dhe objektet për tregtim**

#### **Neni 10**

Depozitat dhe objektet për tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme mund të ndërtohen vetëm në zona të përcaktuara për këtë qëllim nëpërmjet dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe duhet të jenë të pajisura në mënyrë të tillë që të garantojnë mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe sigurinë e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, ambientit dhe të pronës.

Objektet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni mund të ndërtohen dhe rikonstruktohen vetëm në mënyrë që të mos përbëjnë rrezik shpërthimi ose përhapje zjarri, si dhe në distancë sigurie nga vendi i banimit, rrugët publike, linjat hekurudhore, linjat e tensionit të ulët dhe objektet e tjerë të rëndësishme që mund të rrezikohen.

Masat e sigurisë e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, përcaktohen në mënyrë të detajuar me rregullore të ministrisë.

### **Ndalimi i ndërtimit të objekteve të tjera në zonat e rrezikut**

#### **Neni 11**

Në zonat që rrezikojnë objektet e përmendura në nenin 10 i këtij ligji, nuk lejohet ndërtimi i objekteve të tjera, me përjashtim të atyre që shërbejnë për sigurinë e magazinave dhe objekteve për depozitimin dhe tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme.

Zonat e sigurisë bashkë me objektet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni janë zonat në afërsi të drejtpërdrejtë me këto objekte dhe kufijtë e tyre përcaktohen me rregullore të miratuara nga ministria.

### **Shenjat e ndalimit dhe paralajmërimit**

#### **Neni 12**

Në zonat e rrezikut ndalohet:

1) depozitimi i lëndëve dhe pajisjeve të cilat mund të shkaktojnë zjarr ose mundësojnë përhapjen e tij;

2) mbajtja e flakës së hapur ose puna me flakë të hapur (saldime etj.) dhe punë me objekte inkandeshente;

3) pirja e duhanit ose përdorimi i mjeteve ndezëse (shkrepëse, çakmak etj.);

4) përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve të cilat kanë vatër zjarri;

5) puna me vegla ose pajisje të nxjerrin shkëndija;

6) instalimi i përcjellësve elektrikë mbitokësorë, pavarësisht nga tensioni;

7) hyrja e automjeteve gjatë punës me pajisje motorike që mund të hedhin shkëndija;

8) veshja e rrobave ose këpucëve të cilat akumulojnë elektricitet statik dhe përdorimi i mjeteve dhe pajisjeve të cilët nuk janë mbrojtur sipas rregullores për elektricitetin statik.

Shoqëritë tregtare, personat juridikë dhe sipërmarrësit janë të detyruar që në magazinat dhe objektet të cilat depozitojnë ose kryejnë tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme, të vendosin në vende të dukshme etiketa paralajmëruese për ndalimet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, shenja të rrezikut për shpërthim, përhapje zjarri dhe udhëzime për procedurat në rast shpërthimi dhe zjarri.

### **Dërgimi i dokumentit planifikues për dhënien e mendimit**

#### **Neni 13**

Në procedurën e hartimit të dokumenteve të projektplanit për magazinat dhe objektet që do të përdoren për magazinimin ose tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme, subjekti përgjegjës për veprimtaritë përgatitore dërgon dokumentin e projektplanit për miratim nga ministria.

### **Miratimi i dokumentacionit teknik**

#### **Neni 14**

Gjatë ndërtimit dhe rikonstruksionit të objekteve të përmendura në nenin 10 të këtij ligji, investitori është i detyruar që të marrë miratimin e ministrisë për sa i përket mbrojtjes nga shpërthimi, zjarri dhe përhapja e zjarrit.

Miratimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni jepet për dokumentacionin teknik për ndërtimin dhe rikonstruksionin e magazinave dhe objekteve për tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme.

### **Mbrojtja e përhershme fizike dhe teknike**

#### **Neni 15**

Objektet e përmendura në nenin 10 të këtij ligji duhet të jenë nën mbrojtje të përhershme fizike dhe teknike, në përputhje me ligjin e posaçëm.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, objektet në të cilët magazinohen lëngje të ndezshme me vëllim deri 500 m<sup>3</sup> ose gaze deri në 100 m<sup>3</sup> kontrollohen në mënyrën e përcaktuar me akt të përgjithshëm të shoqërisë tregtare, të personit juridik ose sipërmarrësit.

### **Hyrja e personave të paautorizuar**

#### **Neni 16**

Objektet e përmendura në nenin 10 të këtij ligji mbrohen nga hyrja e personave të paautorizuar.

### **Ngrohja**

#### **Neni 17**

Objektet e përmendura në nenin 10 të këtij ligji, si rregull, nuk ngrohen, por në qoftë se ngrohja e ambienteve të caktuara është e domosdoshme, ajo kryhet në përputhje me rregulloret teknike sipas nenit 9 paragrafi 3 të këtij ligji.

### **Aparatet, pajisjet dhe instalimet**

#### **Neni 18**

Objektet e përmendura në nenin 10 të këtij ligji duhet që: të furnizohen me aparate ose pajisje të tjera për fikjen e zjarrit dhe për matjen e përqendrimeve të gazeve të ndezshme; të kenë instalime për ndriçim të këtyre objekteve dhe ambienteve rreth tyre, ndërsa në qoftë se janë objekte mbitokësore duhet të kenë pajisje të posaçme për ftohje dhe instalime rrufepritiëse, në përputhje me ligjin dhe rregulloret teknike sipas nenit 9 paragrafi 3 të këtij ligji.

Shoqëritë tregtare, personat juridikë dhe sipërmarrësit të cilët përdorin objektet e përmendura në nenin 10 të këtij ligji, janë të detyruar të garantojnë funksionimin e duhur të aparateve, pajisjeve dhe instalimeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni.

### **Ajrosja**

#### **Neni 19**

Objektet e përmendura në nenin 10 të këtij ligji duhet të kenë ajrim natyror.

Hapjet për ajrosjen e objekteve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të jenë ndërtuar në mënyrë që të pengojnë depërtimin e ujit dhe që të mos mbyllen vetë.

### **Kushtet për përdorimin e objekteve**

#### **Neni 20**

Përdorimi i objekteve të përmendura në nenin 10 të këtij ligji lejohet pas marrjes së lejes së përdorimit, në përputhje me ligjin dhe vendimin që miraton përdorimin e këtyre objekteve, që lëshohet nga ministria.

## **III. KUSHTET PËR MAGAZINIMIN DHE TREGTIMIN E LËNGJEVE DHE GAZEVE TË NDEZSHME**

## **1. Dispozita të përbashkëta**

### *Kushtet për administrim, programi dhe mënyra e kualifikimit profesional*

#### **Neni 21**

Lëngjet dhe gazet e ndezshme mund të administrohen nga persona fizikë që:

- 1) janë të rritur;
- 2) kanë të paktën arsimin e mesëm në fushën përkatës;
- 3) janë profesionalisht të trajnuar për administrimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshëm, në përputhje me këtë ligj.

Programi dhe mënyra e kualifikimit për administrimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme të përmendura në paragrafin 1 pika 3 të këtij neni përcaktohen me rregulloret e organit të administratës shtetërore kompetent për çështjet e punës, me propozim të Këshillit për Arsimimin e të Rriturve, bashkë me mendimin e ministrisë.

### *Përgjegjësia ndaj dëmit*

#### **Neni 22**

Shoqëritë tregtare, personat juridikë dhe sipërmarrës, të cilët kryejnë magazinimin dhe tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme, janë përgjegjës për dëmin që i shkaktojnë palëve të tretë, i cili vjen nga operacionet e tyre dhe nga detyrimet kontraktore.

## **2. Kushtet për zhvillimin e veprimtarisë së magazinimit dhe tregtimit dhe dhënia e lejes**

### *Leja për magazinim dhe tregtim*

#### **Neni 23**

Magazinimi dhe tregtimi i lëngjeve dhe gazeve të ndezshme mund të kruhet nga shoqëri tregtare, persona juridikë dhe sipërmarrës të cilët janë regjistruar për kryerjen e këtyre veprimtarive dhe të cilët kanë lejen për magazinimin dhe tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme.

Leja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni lëshohet nga ministria.

### *Kushtet për kryerjen e veprimtarisë së magazinimit dhe tregtimit*

#### **Neni 24**

Shoqëritë tregtare, personat juridikë dhe sipërmarrësit e përmendur në nenin 23 të këtij ligji duhet të kenë:

- 1) person përgjegjës;
- 2) punonjësit që do të administrojnë lëngjet dhe gazet e ndezshme;
- 3) një magazinë ose objekt për tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme;

Personi përgjegjës i përmendur në paragrafin 1 pika 1 të këtij ligji duhet të plotësojë kushtet sipas nenit 21 të këtij ligji.

### *Kërkesa për leje*

#### **Neni 25**

Shoqëritë tregtare, personat juridikë dhe sipërmarrësi, bashkë me kërkesën për leje të përmendur në nenin 23 të këtij ligji, bashkëngjisin:

- 1) ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjykatës Tregtare mbi veprimtarinë e regjistruar;
- 2) të dhënat për personin përgjegjës;
- 3) të dhënat për numrin dhe strukturën e punonjësve të cilët do të administrojnë lëngjet dhe gazet e ndezshme;
- 4) lejen e përdorimit për magazinat dhe objektin për tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme;
- 5) të dhënat për plotësimin e kushteve të përmendura në nenet 7, 8 dhe 15 të këtij ligji;

6) të dhënat për llojin dhe vëllimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme të cilët do të magazinohen ose tregtohen.

#### *Ndërprerja e vlefshmërisë së lejes*

##### **Neni 26**

Leja për magazinimin dhe tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme e ndërpret vlefshmërinë me kërkesë të shoqërisë tregtare, personit juridik ose sipërmarrësit të përmendur në nenin 23 të këtij ligji ose në qoftë se kjo shoqëri tregtare, person juridik ose sipërmarrës, nuk plotëson më kushtet e përmendura në nenin 24 të këtij ligji.

#### *Njoftimi për fillimin, ndryshimin dhe ndërprerjen e vlefshmërisë së zhvillimit të veprimtarisë*

##### **Neni 27**

Shoqëria tregtare, personi juridik dhe sipërmarrësit, për të cilët është lëshuar leja për magazinimin ose tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme, janë të detyruar që brenda tetë ditësh nga fillimi, ndryshimi ose ndërprerja e zhvillimit të veprimtarisë, të njoftojë ministrinë.

### **3. Tregtimi i lëngjeve dhe gazeve të ndezshme**

#### *Kushtet për tregtimin e lëngjeve të ndezshme*

##### **Neni 28**

Shoqëritë tregtare, personat juridikë dhe sipërmarrësit janë të detyruar, që para tregtimit të lëngjeve të ndezshme, të përcaktojnë kategorinë e lëngut të ndezshëm sipas temperaturës së ndezshmërisë, kategorisë dhe shkallës së rrezikshmërisë nga shpërthimi, zjarri dhe përhapja e zjarrit në përputhje me rregulloret teknike të përmendura në nenin 9 paragrafi 3 të këtij ligji dhe të përpilojnë udhëzimet për magazinimin, depozitimin dhe tregtimin e sigurt të lëngjeve të ndezshme.

Kontejnerët, enët, shishet dhe shishet e vogla të cilat mbajnë lëngje të ndezshme, gjatë tregtimit, duhet të jenë etiketuar me të dhënat për llojin dhe vëllimin e lëngut të ndezshëm, emrin e prodhuesit dhe distributorit, si dhe të dhënat e përmendura nga paragrafi 1 i këtij neni, që do të shkruhen me shtyp cilësor dhe të dukshëm ose të shtypen direkt mbi kontejnerin, enën, shishen ose shishen e vogël, duke përjashtuar rastet kur përmbajnë lëngje të ndezshme të synuara për ushqim.

#### *Materialet e përdorura për prodhimin e kontejnerëve, enëve, shisheve dhe shisheve të vogla.*

##### **Neni 29**

Kontejnerët, enët, shishet dhe shishet e vogla, të cilët shërbejnë për mbajtjen e lëngjeve të ndezshme, duhet të bëhen me material rezistues ndaj lëngut që mban, të shënohen me shenja të qarta të rrezikshmërisë nga shpërthimi, zjarri dhe përhapja e zjarrit dhe të përmbajnë tekstin e paralajmërimit për mbajtje dhe përdorim të sigurt, sipas mënyrës së përcaktuar nga rregulloret teknike të përmendura në nenin 9 paragrafi 3 të këtij ligji.

#### *Të dhënat për grupin e lëngjeve të ndezshme*

##### **Neni 30**

Shoqëritë tregtare, personat juridikë dhe sipërmarrësit që merren me magazinimin dhe tregtimin e lëngjeve të ndezshme, përveç lëngjeve të ndezshme me karakteristika të zakonshme, janë të detyruar të kenë të dhënat për grupin e lëngjeve të ndezshme sipas temperaturës së ndezshmërisë, kategorisë dhe shkallës së rrezikshmërisë nga shpërthimi, zjarri dhe përhapja e zjarrit, në përputhje me rregulloret teknike të përmendura në nenin 9 paragrafi 3 i këtij ligji.

#### *Kushtet për tregtimin e gazeve të ndezshme*

##### **Neni 31**

Shoqëritë tregtare, personat juridikë dhe sipërmarrësit janë të detyruar që para tregtimit të gazeve të ndezshme me kontejnerë, enë, shishe ose shishe të vogla, të përpunojnë udhëzimet me shkrim për magazinimin, depozitimin dhe tregtimin e sigurt, me të dhënat për llojin dhe vëllimin e gazit, si dhe për kategorinë dhe shkallën e rrezikshmërisë nga shpërthimi, zjarri dhe përhapja e zjarrit, në përputhje me rregulloret teknike të përmendura në nenin 9 paragrafi 3 të këtij ligji.

Kontejnerët dhe enët të cilat përmbajnë gaze të ndezshme, duhet të etiketohen, ngjyrosen dhe të prodhohen me materiale në përputhje me rregulloret teknike të përmendura në nenin 9 paragrafi 3 i këtij ligji dhe duhet që para dhe gjatë përdorimit të kontrollohen në mënyrën dhe në afatet e përcaktuara në këto rregullore.

Shishet dhe shishet e vogla të cilat përmbajnë gaze të ndezshme duhet të prodhohen me material rezistent ndaj gazit të ndezshëm që mban dhe të etiketohen me simbole të qarta të rrezikut nga zjarri dhe me tekstin paralajmërues për mbajtje dhe përdorim të sigurt.

### *Të dhënat për llojin dhe shkallën e rrezikshmërisë*

#### **Neni 32**

Shoqëritë tregtare, personat juridikë dhe sipërmarrësit, të cilët kryejnë magazinimin dhe tregtimin e gazeve të ndezshme, përveç gazeve të ndezshme me karakteristika të zakonshme, janë të detyruar të kenë të dhënat për llojin dhe shkallën e rrezikshmërisë nga shpërthimi, zjarri dhe përhapja e zjarrit, në përputhje me rregulloret teknike të përmendura në nenin 9 paragrafi 3 i këtij ligji.

### *Shitja në objektet e shitjes*

#### **Neni 33**

Lëngjet dhe gazet e ndezshme në enë, shishe ose shishe të vogla mund të shiten vetëm në objektet e shitjes së lëngjeve dhe gazeve të ndezshme.

Në rast të veçantë, shitja e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme në shishe të vogla mund të kryhet jashtë objekteve të shitjes së lëngjeve dhe gazeve të ndezshme, në qoftë se vëllimi i përgjithshëm i tyre nuk kalon 20 l.

### *Shitja në paketim origjinal*

#### **Neni 34**

Në objektet e shitjes mund të shiten lëngje dhe gaze të ndezshme vetëm në paketim origjinal dhe të padëmtuar.

## **4. Testimi i instalimeve**

### *Testimi i instalimeve të gazit*

#### **Neni 35**

Instalimet e gazit në objektin ose në pjesë të objektit duhet të kryhen në përputhje me projektin e instalimit të gazit sipas rregulloreve teknike të përmendura në nenin 9 paragrafi 3 të këtij ligji, ose në përputhje me rregullat e praktikës teknike.

Para dorëzimit të instalimit të gazit në objekt ose në një pjesë të tij, është i detyrueshëm testimi i instalimit në lidhje me rregullsinë dhe padepërtueshmërinë, në përputhje me projektin e instalimit të gazit për të cilin duhet të bëhet dokumentacioni.

Distributori është i detyruar të testojë rregullsinë dhe padepërtueshmërinë e instalimit të gazit nga rruga, ose e rezervuarit të gazit deri te pajisja në objekt ose në pjesën e objektit për banim, jo më pak se 10 vjet gjatë ndryshimit, ose kalibrimit të gazometrit, në qoftë se me rregullore nuk përcaktohet afat më i shkurtër.

Organet e administratës shtetërore dhe lokale, shoqëritë tregtare, personat juridikë dhe sipërmarrësit, të cilët përdorin gaze të ndezshme për ngrohjen e ambienteve të punës ose në procesin teknologjik, janë të detyruar që t'i mundësojnë distributorit të gazit, pa asnjë pengesë, testim të rregullsisë dhe padepërtueshmërisë së instalimeve të gazit nga lidhja e rrugës ose e rezervuarit deri në

pajisje, të paktën një herë në pesë vjet, në qoftë se me rregullore nuk është parashikuar afat më i shkurtër.

Vërtetimi për rregullsinë dhe padepërtueshmërinë e instalimit të gazit jepet nga distributori.

Kostoja për testimin e rregullsisë dhe padepërtueshmërisë së instalimeve të gazit parashikohet nga organi i administratës shtetërore kompetent për energjinë.

### *Ndërprerja e furnizimit me gaz*

#### **Neni 36**

Në qoftë se në procedurën për rregullsinë dhe padepërtueshmërinë e instalimeve të gazit të përmendur në nenin 35 të këtij ligji konstatohet se instalimi nuk është i rregullt, rrjedh gaz ose nuk është kryer në përputhje me projektin ose me rregulloret teknike, distributori është i detyruar që të ndërpresë furnizimin me gaz të konsumatorit tek i cili janë konstatuar parregullsitë, deri në mënjanimin e tyre.

### **IV. MBIKËQYRJA Kryerja e mbikëqyrjes**

#### **Neni 37**

Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji dhe e akteve nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji kryhet nga ministria.

Detyrat e mbikëqyrjes inspektuese në kuadrin e kompetencave të ministrisë kryhen nga shërbimet e inspektimit për lëndët plasëse, lëndët, lëngjet dhe gazet e ndezshme, në përputhje me ligjin.

### **Masat dhe veprimet administrative**

#### **Neni 38**

Krahas masave administrative dhe veprimeve të përcaktuara me ligj me të cilin është rregulluar mbikëqyrja inspektuese, inspektori për lëndët plasëse, lëndët, lëngjet dhe gazet e ndezshme, në mënyrë të veçantë është i autorizuar të ndalojë:

- tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme, në qoftë se kushtet e përcaktuara nga ligji ose rregulloret teknike nuk janë për përmbushur;
- administrimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme nga persona të cilët nuk janë të kualifikuar profesionalisht për administrimin e tyre;
- përdorimin e magazinave ose ambienteve të tjera për magazinimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në këtë ligj ose nga rregullore teknike;
- magazinimin, depozitimin dhe tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme në sasi mbi ato të lejuara, si dhe magazinimin, depozitimin dhe tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme që nuk lejohen.

Inspektori për lëndët plasëse, lëndët, lëngjet dhe gazet e ndezshme mund të ndalojë përkohësisht kryerjen e veprimeve të veçanta në lidhje me magazinimin, depozitimin dhe tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme, në qoftë se konstatohen parregullsi gjatë marrjes së masave të sigurisë për mbrojtjen nga shpërthimi, zjarri dhe përhapja e zjarrit.

### **V. DISPOZITA PENALE**

#### **Neni 39**

Për shkelje, dënohet me gjobë nga 20 deri 300 fish i pagës minimale në Malin e Zi, shoqëria tregtare, personi juridik ose sipërmarrësi, në qoftë se:

1) personat që administrojnë ose kryejnë veprime të tjera në lidhje me lëngjet dhe gazet e ndezshme nuk janë njohur me masat e sigurisë ose nuk janë trajnuar për veprimet në rast aksidenti tekniko – teknologjik ose aksidenti tjetër, siç përcaktohet nga rregulloret për mbrojtjen dhe shpëtimin (neni 8);

2) në magazinat dhe objektet në të cilat magazinohen ose tregtohen lëngje dhe gaze të ndezshme, në vende të dukshme nuk janë vendosur shenjat përkatëse të rrezikut nga zjarri dhe shpërthimi ose udhëzimet për veprimet në rast zjarri dhe shpërthimi (neni 12 paragrafi 2);

3) magazinat dhe objektet e përdorura për magazinimin dhe tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme nuk janë të mbrojtura nga hyrja e personave të paautorizuar (neni 16);

4) magazinat dhe objektet e përdorura për magazinimin dhe tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të

ndezshme nuk janë pajisur me aparate dhe pajisje të tjera për fikjen e zjarrit, aparate për matjen e përqendrimit të gazeve të ndezshme dhe me rrufepritis ose në qoftë se këto aparate, pajisje dhe instalime, nuk mbahen në gjendje të rregullt (neni 18);

5) hapjet për ajrimin e magazinave dhe objekteve të përdorura për magazinimin ose tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme nuk i ndërtojnë në mënyrë që të mos depërtojë uji dhe të mos mbyllën vetë apo të mbeten të mbyllura (neni 19 paragrafi 2);

6) urdhëron ose lejon administrimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme nga persona të cilët nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara (neni 21);

7) para tregtimit të lëngjeve dhe gazeve të ndezshme, nuk pasqyron grupin e lëngjeve të ndezshme sipas temperaturës së ndezshmërisë, kategorisë dhe shkallës së rrezikshmërisë nga shpërthimi, zjarri dhe përhapja e zjarrit ose nuk harton udhëzimet për magazinim, depozitim dhe tregtim të sigurt të lëngjeve të ndezshme (neni 28 paragrafi 1);

8) para tregtimit të gazeve të ndezshme me kontejnerë, enë, shishe ose të vogla, nuk harton udhëzimet me shkrim për magazinimin, depozitimin dhe tregtimin e sigurt, me të dhënat për llojin dhe vëllimin e gazit, si dhe kategorinë dhe shkallën e rrezikshmërisë nga shpërthimi, zjarri dhe përhapja e zjarrit (neni 31 paragrafi 1);

9) në objektet e tyre të shitjes, shet lëngje dhe gaze të ndezshme të cilët nuk kanë paketimin origjinal dhe të padëmtuar (neni 34);

10) nuk ndërpret furnizimin me gaz të konsumatorit tek i cili është konstatuar se instalimi nuk është i rregullt, rrjedh gaz ose nuk është bërë në përputhje me projektin e instalimit të gazit (neni 36);

Shkeljet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni shoqërohen me gjoja ndaj personit përgjegjës në personin juridik nga 5 deri në 20 fish të pagës minimale në Malin e Zi.

+

**Shih:**

**Korrigjim - 31/2010-26.**

#### **Neni 40**

Gjoja ekuivalente me 3 deri në 10 fish të shumë së pagës minimale në Malin e Zi do të vendoset për personi fizik në qoftë se administron lëngje dhe gaze të ndezshme dhe nuk plotëson kushtet e përcaktuara.

### **VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Rregulloret për zbatimin e ligjit**

##### **Neni 41**

Rregulloret për zbatimin e këtij ligji miratohen në afatin prej dy vitesh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në miratimin e rregulloreve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, do të zbatohen rregullohet të cilat kanë qenë në fuqi deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, në qoftë se nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

#### **Harmonizimi i operacioneve dhe veprimtarive me ligjin**

##### **Neni 42**

Shoqëritë tregtare, personat juridikë dhe sipërmarrësit të cilët merren me magazinimin, depozitimin dhe tregtimin e lëngjeve dhe gazeve të ndezshme, janë të detyruar të harmonizojnë operacionet dhe veprimtaritë e tyre me këtë ligj dhe me rregulloret e miratuara për zbatimin e këtij ligji brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Shfuqizimi i ligjit të vjetër**

##### **Neni 43**

Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet ligji për lëndët plasëse, lëngjet dhe gazet e ndezshme ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 44/76, 49/76, 34/86 dhe 11/88), në pjesën e cila lidhet me lëngjet dhe gazet e ndezshme.

#### **Hyrja në fuqi**

##### **Neni 44**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga data e botimit të tij në "Gazetën Zyrtare të Malit të Zi".

SU-SK nr. 01-36/12  
Podgoricë, prill 2010

**Kryesia e Malit të Zi, mbledhja 24**

Presidenti  
**Ranko Krivokapić, d.v.**

## **NDRYSHIME**

Pas krahasimit të kryer me tekstin origjinal, u konstatua se në tekstin e ligjit për lëngjet dhe gazet e ndezshme, të botuar në “Gazetën Zyrtare të Malit të Zi”, numër 26/10, u gjet gabimi teknik, dhe bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

### **Korrigjim i ligjit për lëngjet dhe gazet e ndezshme**

*Korrigjimi është botuar në “Gazetën Zyrtare të Malit të Zi”, nr. 31/2010 datë 4.6.2010.*

Në nenin 39 pika 8, fjalët: “(neni 32 paragrafi 1)” zëvendësohen me fjalët: “(neni 31 paragrafi 1)”.

**Shërbimet teknike të Kuvendit të Malit të Zi**